

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ngre shqetësime serioze për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë
ADRESA	https://albeu.com/kosove/keshilli-i-ambasadoreve-shqiptare-ngre-shqetesime-serioze-per-a-ktgjykimin-e-dhomave-te-specializuara-ne-hage/1014784/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:50:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:48:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de44b81a3888fbd2459faba8ebd35255f7f983b81bb0cfc43279d4873a04b251
TEKSTI	1e76a9ed48cc33c791b6f4ffbef896198bb0884871eb408931cee0ecf1bde394
PAMJA	0134bc48896fa0b63260ba3e79248c2f3f1769758a19ac6147be916a0b00268f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c0b1610ee1032a59170e559411290c1f95931cc7ec2314cc840231917c6edde6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c0b1610ee1032a59170e559411290c1f95931cc7ec2314cc840231917c6edde6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ngre shqetësime serioze për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë (KASH) ka deklaruar se e ka pritur me shqetësim të thellë aktgjykimin e shkallës së parë, të shpallur nga Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KASH thekson se respekton shtetin e së drejtës, pavarësinë e organeve gjyqësore dhe të drejtën e çdo viktime për të kërkuar drejtësi, por shpreh thellësisht i zhgënjyer nga ky vendim. Sipas tij, pikëpyetje të mëdha ngrihen edhe për zgjatjen e pazakontë të procesit, mbajtjen shumëvjeçare të të akuzuarve në paraburgim, përpjesëtueshmërinë e dënimeve dhe standardet e përdorura gjatë gjyqimit.

Në qëndrimin e tij, Këshilli rikujton se Ushtria Çlirimtare e Kosovës zhvilloi një luftë të drejtë çlirimtare përballë shtypjes, spastrimit etnik dhe dhunës së organizuar nga regjimi i Slobodan Millosheviçit. Përpjekja e UÇK-së kishte mbështetjen e botës demokratike, ndërsa ndërhyrja e NATO-s ndali një tragjedi humanitare që kishte detyruar rreth një milion shqiptarë të Kosovës të braktisnin shtëpitë e tyre.

KASH nënvizon se aparati shtetëror, ushtarak dhe policor i regjimit të Millosheviçit, bashkë me drejtues të lartë të tij, është gjykuar dhe dënuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për krimet e kryera në Kosovë dhe në zona të tjera të ish-Jugosllavisë. Vrasjet, masakrat, dëbimet e dhunshme dhe përndjekja sistematike e civilëve, të dokumentuara si krime të këtij regjimi, nuk mund të minimizohen dhe as të vendosen në të njëjtin plan me luftën për liri të popullit të Kosovës dhe të udhëheqësve të tij.

Sipas Këshillit, vendimi ndaj katër ish-drejtuesve të UÇK-së nuk përbën dhe nuk duhet të lexohet si dënim i popullit të Kosovës, i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo i përpjekjes së saj për liri dhe pavarësi. Asnjë aktgjykim nuk mund të cenojë sakrificën e mijëra dëshmorëve dhe viktimave, të mohojë të drejtën historike të Kosovës për të qenë e lirë apo të zhbëjë dallimin thelbësor mes agresorit dhe viktimës. Karakteri çlirimtar i luftës dhe historia e Kosovës nuk mund të ndryshohen.

të fundit /



Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ngre shqetësime serioze p...



Shqetësim në Frankfurt pas dy viktimitave nga malaria, hetohet...



Kostadinovski kërkon masa rrënjësore për të rivendosur besimin te...



Pas aktgjykimit në Hagë, OVL-UÇK thërret për nesër Këshillin...



Cilët janë hapat që ndërmerren për apelin e një vendi...



I riu plagoset me a*më zjarri në zonën e Vollgës në Durrës



Ganimete Musliu reagon ndaj vendimit të Gjykatës Speciale



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vëren se reagimet e para nga faktori ndërkombëtar kanë vënë sërish në dukje rëndësinë e drejtësisë dhe të përgjegjshmërisë. Ndërkohë, aktgjykimi ka nxitur kundërshtime dhe shqetësime të forta si në Kosovë, ashtu edhe në diasporë.

Në këto rrethana, KASH u kërkon partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës të shfaqin një pozicion të qartë dhe të ekuilibruar. Respekti për procedurat gjyqësore, sipas tij, nuk duhet të përdoret për të relativizuar agresionin serb, për të krijuar barazi morale mes palëve apo për të riformuluar historinë e luftës çlirimtare të Kosovës.

KASH pret që gjatë apelimit të analizohen me paanshmëri dhe rigorozitet të plotë provat, konkluzionet juridike, mënyra se si është përcaktuar përgjegjësia dhe proporcionaliteti i dënimeve. Në të njëjtën kohë, duhet të garantohen të gjitha të drejtat e të dënuarve për një proces të drejtë. Këshilli kujton se aktgjykimi është vetëm i shkallës së parë dhe se mundësitë ligjore ende nuk janë konsumuar.

Po ashtu, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i kërkon bashkësisë ndërkombëtare që standardet e njëjta të drejtësisë të zbatohen edhe për krimet masive të kryera në Kosovë nga forcat shtetërore serbe. Drejtësia nuk mund të konsiderohet e plotë, e barabartë dhe e besueshme ndërsa një numër i madh personash përgjegjës për masakra, dëbime, dhunë seksuale, shkatërrime dhe zhdukje me forcë vazhdojnë të mos ndëshkohen.

Në përfundim, KASH shpreh solidaritet me popullin e Kosovës dhe familjet e të dënuarve, ndërsa apelon për qetësi, bashkim, dinjitet dhe besim te mjetet juridike që parashikon ligji.

Shtuar më 16.09.2026 18:48

Tags: [Dhomave të Specializuara](#), [Hagë](#), [Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë](#)



Pas aktgjykimit në Hagë, OVL-UÇK thërret për nesër Këshillin Drejtues



Cilët janë hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Speciales



Ganimete Musliu reagon ndaj vendimit të Gjykatës Speciale



Jashari apelon për qetësi dhe maturi, kërkon zhbërjen e Gjykatës...



Protesta në Hagë, policia holandeze njofton për dy të arrestuar dhe një zyrtar t...



Vendimi ndaj komandantëve të UÇK-së, Nik Gjelosaj: Një ditë zi...



Haradinaj kërkon reagim nga Qeveria pas vendimit ndaj ish-drejtuesve të UÇ...



Jashari: Kosova po përjeton një ditë të rëndë, të gjendet mënyra për...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.